

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E HËNË 23 MAJ 2022

I zbuluar nga një mision arkeologësh italianë në vitin 1920, Butrinti, i cili mendohet të jetë ndërtuar në shekullin VIII para Krishtit, mbetet një nga pasuritë më të mëdha arkeologjike, por njëkohësisht historike, mjedisore e kulturore. Në fakt, kolege, ti meriton më shumë respekt se sa zhurmuesin nëpër komisione e në këtë foltore. Në broshurat e viteve të shkuara informohesh për aktivitete kulturore, të cilat shumë nga ne këtu, për moshën që kemi, i mbajmë mend si festivale kombëtare, por edhe shumë festivale të tjera ndërkombëtare modeste, në një teatër i cili ka 23 rreshta dhe ku mund të ulen 1500 vetë.

Sa herë që shkoj në zonën time elektorale, ku shpesh nuk ju kam parë, nga Saranda deri në Konispol, veçanërisht në Butrint, ndjej trishtim për faktin se në aspektin e zhvillimit, kjo zonë është akoma nën mesataren. Në fakt, ky është një lajm i mirë sot. Në fakt, janë gjithë këto javë e gjithë këto ditë që po debatojmë dhe diskutojmë, ndërkohë që potenciali i zhvillimit, jo vetëm i asaj që është Parku Arkeologjik apo Parku i Butrintit, por e gjithë zona, për ata që janë aty dhe jetojnë aty, ky lajm pritet si një lajm i mirë për të zhvilluar ekonominë e tyre familjare, që nga ajo rurale deri tek ajo urbane. Nuk është vetëm infrastruktura ajo që do të përmirësohet, por mbi të gjitha është jeta edukative e kulturore e banorëve, e fëmijëve tanë, të cilëve do të duhet t'ua përcjellim më shpesh vlerat e këtij Parku Arkeologjik historik dhe kulturor, por njëkohësisht edhe të gjithë turistëve që pritet të vijnë nga shumë zhvillime të tjera infrastrukturore, që kjo zonë do të ketë viteve të ardhshme.

Nuk mjafton vetëm rruga Kardhiq-Delvinë, që shpresoj të mbarojë këtë vit dhe jam e bindur se do të jetë një ngjarje shumë e rëndësishme për të gjithë zonën, për të gjithë turistët vendës e të huaj, por dhe aeroporti i Sarandës gjatë tre-katër viteve të ardhshme, që do të sjellë shumë vizitorë, duke e bërë këtë sit të vizituar, por mbi të gjitha do të rrisë vlerën e kësaj pasurie kombëtare, që sapo përmendëm. Prandaj, nëse shkoni sot, apo keni shkuar vjet, unë nuk e di se kush është ai që ka shkuar vjet apo sivjet, do të jeni dakord për atë sipërfaqe jashtë ambientit të Butrintit, që është komode dhe të nderon për këtë pasuri kulturore në aspektin infrastrukturor. Për të mos folur më pas për gjatësinë e kohës së udhëtimit të vizitës në Parkun e Butrintit apo për diskutimet që bëjnë edhe në komisionet parlamentare në aspektin e minimalës së higjienës që do të duhet për të përballuar numrin aktual të vizitorëve, jo më të atyre që do të vijnë.

Sistemi aktual i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Butrintit nuk është ai që duhet të jetë, nuk është ai që meriton ky sit, aq më tepër që meriton ekonomia shqiptare. Prandaj, ky sistem është revizuar, është konsultuar. Me Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit, që është krijuar në vitin 2021, dhe me marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, është vënë në vëmendje të shumë projekteve të viteve të ardhshme. Shumëkush në këtë sallë dhe në të gjithë Shqipërinë i kanë parë veprat, ndaj jam e bindur se kushdo që do të flasë sot për Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim nuk mund të mohojë punën që fondacioni ka bërë në shumë qytete. Nuk dua të bie në përsëritje, por në bashkëpunimin me ta, si ministre e Financave, unë kam vlerësuar modelin e zhvillimit ekonomik në këto zona, sidomos në ato ku janë pazaret.

Nuk ka sjellë vetëm një estetikë infrastrukturore, por mbi të gjitha ka sjellë një model zhvillimi, që ka pasuruar bizneset, të voglat e të mesmet, por dhe të gjithë jetën ekonomike, artistike e kulturore në këto vende. Prandaj, të thuash se po i jepet privatit, është e tepërt, por të diskutosh se Butrinti po kalon me koncesion, do të thotë se nuk njih parimet bazë ekonomike dhe se çfarë është koncesioni. Dua të sjell shtatë fakte për të mbajtur mend, sepse edhe koha është e limituar. Së pari, Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit është regjistruar me kërkesat e ligjit “Për organizimin dhe funksionin e organizatave jofitimprurëse”, ndaj e theksoj përsëri: jofitimprurëse. Të gjitha të ardhurat nga Butrinti do të shkojnë në mbrojtjen dhe zhvillimin e tij.

Nuk do të shkojë në buxhetin e shtetit, por do të riinvestohet për të dinamizuar pikërisht atë plan biznesi dhe për të zhvilluar më tej të gjithë objektivin, me synim konservimin, mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Kemi diskutuar të pavërteta në Komisionin e Ekonomisë, se si do të trefishohet çmimi i biletës. Shkoni e shikojeni çmimin e biletës. Edhe vitin e kaluar, kur e vizituat me djalin tuaj, nuk besoj se çmimi ka qenë i ndryshëm. Ndërkohë, në relacion është 7 deri në 11 dollarë dhe do të ndryshojë me inflacion. Të thuash se do të trefishohet çmimi i biletës, do të thotë vazhdim i propagandës zhurmuese, e cila ka filluar që prej fillimit të vitit. Megjithatë, duke u kthyer te Butrinti, dëgjuam, por nuk pamë në asnjë pjesë të biznesplanit apo të marrëveshjes ndërtimin e restoranteve, hoteleve e bareve brenda Parkut Arkeologjik.

Sigurisht, pamë ndërtimin e një qendre vizitorësh, e cila shkon në një vlerë prej gati 2, 6 milionë dollarësh, për t'i shërbyer këtij fluksi të shtuar, që ministrja e përmendi, ndaj nuk dua të bie në përsëritje. Sigurisht, nuk do të ngrihet mbi rrënoja, sepse nuk është një plan menaxhimi, i cili do të jetë në kundërshtim me atë që është pasuria arkeologjike dhe kulturore, aq më tepër me rregullat e përcaktuara si nga ministria, ashtu edhe nga UNESCO. Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim sjell

afërsisht 5 milionë dollarë, dhe së bashku me 2, 1 milionë dollarë të akumuluar në vite nga Butrinti, nga njësia që sot menaxhon Butrintin, do të shërbejnë për të zhvilluar këtë infrastrukturë të domosdoshme. Është folur pa fund për rolin e shtetit.

Unë nuk dua të merrem me modele, por me rolin e shtetit. Nuk ka nevojë të flasim për modele, por të flasim nëse roli i shtetit është i cenuar apo jo. Në cilën pjesë të marrëveshjes shikoni se prona e shtetit është tjetërsuar? Në asnjë nen të kontratës nuk ka tjetërsim të pronës së shtetit, ndryshe nuk do të ishte Ministria e Kulturës, por do të ishte Ministria e Financave, sepse ajo është pronare. Vazhdoni me të pavërtetat për tjetërsim të pronës publike, por ndërkohë shteti do të vazhdojë të luajë rolin e tij në lidhje me pasurinë kulturore të Butrintit, nëpërmjet një bordi menaxhimi me pesë anëtarë, ku bëjnë pjesë anëtarë ndërkombëtarë, anëtarë të fondacionit dhe është vetë Ministri i Kulturës ai që drejton dhe do ta drejtojë në dhjetë vjet.

Sot është zonja Margariti, e më pas kushdo që do ta ketë nderin dhe privilegjin të drejtojë atë ministri gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm. Sigurisht, me eksperiencën time parlamentare e shikoj se këto të pavërteta janë bërë rutinë, por megjithatë as ne nuk do të reshtim së kundërshtuari me fakte të pavërtetat tuaja. Shkojmë te pika 6, monitorimi i veprimtarisë së fondacionit. Si rezultat i nevojës për ta monitoruar në mënyrë të vazhdueshme, është ngritur një njësi monitorimi në Ministrinë e Kulturës. Është vendosur që auditimi i veprimtarisë financiare do të realizohet nga një prej big four-ëve apo kompanive më prestigjioze të auditimit në Shqipëri, gjë e cila do të jetë publike. Atë do ta shikojnë edhe financierët, edhe parlamentarët, por dhe cilido qytetar që ka interesa.

Së fundi, nevoja për të ruajtur këtë pasuri është obligim i shtetit shqiptar dhe është në marrëveshjen e kësaj kontrate, e specifikuar në mënyrë të veçantë, që e drejta e ndërhyrjes së ministrisë përshkallëzohet më tej kur vihet në rrezik ruajtja e pasurisë kulturore. Kjo si pasojë, nëse ndodh braktisja e pasurisë kulturore nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, ngjarjeve që cenojnë sigurinë kombëtare apo ngjarje të forcës madhore. Gërmimet arkeologjike, si një pjesë e studiuar e planit të punës, në të ardhmen do të bëjnë bashkë ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, por, mbi të gjitha, do të bëjnë bashkë të rinjtë dhe të rejat që synojnë në 10 vjetët e ardhshëm të zhvillojnë profesionet e tyre dhe ta rrisin atë më shumë. Bonifikimi i Fushës së Vrinës, duke krijuar edhe shkarkimet e ujërave, nuk është një risi.

Në fakt, janë investime të kryera në vitet 1970-1980 dhe natyrshëm është një periudhë e rëndësishme, ku kultura, arkeologjia dhe mjedisi kanë qenë dhe vijojnë të jenë në fokus edhe me këtë plan të

menaxhimit në të ardhmen. Mbretëresha e Butrintit, që ne të dyja e dimë shumë mirë se si tregtohet rrugëve të Sarandës në diell, jo gjithmonë u mbijeton temperaturave, që si rrjedhojë edhe e ngrohjes globale, nuk e ndihmojnë parashikueshmërinë dhe në këtë drejtim është shumë e nevojshme ta vendosim të gjithë konceptin e nevojës për investim jo thjesht në një gjërmim, në një zonë parkimi, në një qendër të vizitorëve, por në të gjithë ekosistemin, duke filluar nga ai arkeologjik, mjedisor, kulturor dhe ekonomik, ndaj është shumë e rëndësishme t'i informoni shqiptarët për të gjitha elementet e kësaj kontrate, të këtij plani menaxhimi në 10 vjetët e ardhshëm, jo vetëm të bëni debate për të gjitha modelet e vendeve të tjera, sepse një model nuk i ngjan tjetrit.

Për ne është e rëndësishme: a është ky një model suksesi në 10 vjetët e ardhshëm? A është ky një model që do ta rrisë imazhin e Butrintit dhe të kësaj perle të arkeologjisë dhe kulturës, por, mbi të gjitha të ekonomisë së banorëve që unë dhe ju u kemi kërkuar votat, të cilët na kanë votëbesuar dhe ne duhet të jemi të sinqertë. Faleminderit!